

VENDIM
Nr. 277, datë 6.4.2020

PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE TË HUAS ME BANKAT E NIVELIT TË DYTË PËR PAGAT E TREGTARËVE OSE SHOQËRIVE TREGTARE, AKTIVITETI I TË CILAVE ËSHTË PREKUR NGA VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NË KUADËR TË MENAXHIMIT TË SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID-19, SI EDHE PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE E TË KRITEREVE TË MARRËVESHJES SË GARANCISË DHE MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT

(ndryshuar me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 38, të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e linjës së garancisë shtetërore, në vlerën 11 000 000 000 (njëmbëdhjetë miliard) lekë, në favor të bankave të nivelit të dytë, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pjesë e skemës së garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

2. Linja e garancisë shtetërore lëshohet në favor të secilës bankë të nivelit të dytë, si më poshtë vijon:

- “Raiffeisen Bank”, sh.a., Albania, në vlerën 1 900 000 000 lekë;
- “Banka Tirana”, sh.a., në vlerën 600 000 000 lekë;
- “Banka Union”, sh.a., në vlerën 600 000 000 lekë;
- “Banka Intesa Sanpaolo Albania”, sh.a., në vlerën 900 000 000 lekë;
- “Banka Kombëtare Tregtare”, sh.a., në vlerën 1 900 000 000 lekë;
- “Banka OTP Albania”, sh.a., në vlerën 1 100 000 000 lekë;
- “Banka Procredit”, sh.a., në vlerën 400 000 000 lekë;
- “Banka Alpha Albania”, sh.a., në vlerën 700 000 000 lekë;
- “Banka Amerikane e Investimeve”, sh.a., në vlerën 500 000 000 lekë;
- “Banka Credins”, sh.a., në vlerën 2 000 000 000 lekë;
- “Banka e Bashkuar e Shqipërisë”, sh.a., në vlerën 100 000 000 lekë;
- “Banka e Parë e Investimeve, Albania”, sh.a., në vlerën 300 000 000 lekë.

3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka të drejtë që, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse, nëse është e nevojshme, sipas raportit të strukturës së posaçme ndërinstitucionale, i propozon Këshillit të Ministrave rialokimin e shumës së garancisë, nga huadhënësi që nuk e ka ezuaruar shumën e garancisë në favor të tij te huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.

4. Në skemën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, nuk përfshihen tregtarët ose shoqëritë tregtare, të cilat para miratimit të tij janë subjekt i përfitimit nga skema e subvencionimit të pagës sipas vendimit nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të së

ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”.

5. Marrëveshjet e garancisë janë sipas kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes tip që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Autorizohet ministri i Financave dhe Ekonomisë për nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë me secilën nga bankat e nivelit të dytë.

7. Marrëveshja e mirëkuptimit, e cila nënshkruhet nga huamarrësi, do të përmbajë kushtet sipas marrëveshjes tip të integruar si aneks në marrëveshjen tip të përmendur në pikën 5, të këtij vendimi.

8. Struktura e posaçme ndërinstitucionale, e cila do të monitorojë, shqyrtojë dhe raportojë, periodikisht, pranë ministrit të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancisë shtetërore, miratohet me urdhër të Kryeministrit.

9. Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave
Përfaqësuar nga
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Banka XYZ

Nr. _____ Prot.
Tiranë, më _____.____.2020

Nr. _____ Prot.
Tiranë, më _____.____.2020

**MARRËVESHJE GARANCIE
PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË BIZNESEVE, AKTIVITETI I TË CILËVE
ËSHTË PREKUR NGA SITUATA E KRIJUAR NGA COVID-19¹**

(MARRËVESHJE TIP)
(ndryshuar me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

[xxxxxxxxxxxx] Lekë

Data e hyrjes në fuqi
[_____]

¹ Sipas vendimit nr. 370, datë 6.5.2020:

1. Në tekstin e marrëveshjes tip (të garancisë) bashkëlidhur vendimit nr. 277, datë 6.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Shtesat dhe ndryshimet, sipas pikës 1, të reflektohen në marrëveshjet e garancisë që janë lidhur me bankat e nivelit të dytë, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

PREAMBUL

Qëllimi i skemës së garancisë është që të stimulojë huadhënien për të mundësuar pagesën e pagave të punonjësve të shoqërive tregtare, veprimtaria e të cilëve është prekur nga masat e ndërmarra nga qeveria në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.

Kjo marrëveshje garancie ("Marrëveshja e Garancisë") e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe perfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ("MFE") dhe [Bankës XYZ] ("Huadhënësi"), bëhet për të përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes së Huadhënësit në këtë skemë garancie të administruar nga MFE.

Marrëveshja e Garancisë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin (në këtë Marrëveshje perfaqësuar nga MFE), por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë ("Huamarrësi") nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar ("Huaja"), në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë ("Marrëveshja e Huasë").

Për sa më sipër, si edhe për të mundësuar realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje palët bien dakord me kushtet si më poshtë:

Neni 1 (Baza ligjore)

Kjo Marrëveshje është hartuar në zbatim të:

-Neneve 34-43 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

-Nenit 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

-Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;

-Aktit normativ nr. 6, datë 21.03.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020";

-Pikës 6 të vendmit nr.243, datë 24.03.2020, "Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore";

Neni 2 (Garancia)

(shtuar pika 2/1 me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

1. MFE merr përsipër të garantojë Huadhënësin deri në shumën [xxxxxxx] Lekë. Kjo shumë përfaqëson shumën maksimale të pagesave që do të kryhen nga MFE për të shlyer detyrimet e papaguara ndaj Huadhënësit që burojnë nga Huatë që do t'i nëshetrohen kësaj skeme garancie.

2. MFE merr përsipër të garantojë deri në shumën e cituar në pikën 1 të këtij neni, 100% principalin e Huave, të cilat Huadhënësi do t'u lëvrojë Huamarrësve sipas kushteve që pasojnë në këtë Marrëveshje.

2/1. MFE krahas garantimit të principalit sipas pikës 2 të këtij neni, merr përsipër të rimbursojë interesat e Huave që do të trajtohen nën këtë Marrëveshje Garancie në përputhje me nenin 7/1 të kësaj Marrëveshjeje.

3. MFE nuk merr përsipër në asnjë rast garantimin e interesave ose penaliteteve që mund të burojnë nga Huatë që Huadhënësi do t'u lëvrojë Huamarrësve.

4. Shuma maksimale e akumuluar e disbursimeve të Huave nuk duhet të tejkalojë shumën e cituar në pikën 1 të këtij neni. Asnjë disbursim i ri i ndonjë Huaje nuk do të garantohet nga kjo Marrëveshje, me përjashtim të rastit kur shuma totale e principalit të të gjitha disbursimeve të mëparshme të Huave, sëbashku me disbursimin e ri nuk tejkalon shumën maksimale të akumuluar të disbursimeve.

5. Në rastin kur Huadhënësi e ka ezauruar të gjithë shumën e garancisë në dispozicion të tij sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij neni, Huadhënësi duhet të njoftoj me shkrim MFE-në brenda një afati prej 5 ditë pune.

6. MFE gëzon të drejtën që pas 60 ditësh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, nëse e sheh të arsyeshme të ndërmarrë masat e nevojshme për rialokimin e shumës së garancisë nga Huadhënësi që nuk e ka ezauruar shumën e garancisë në favor të tij, tek Huadhënësi që e ka ezauruar atë plotësisht.

Neni 3

(Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve)

(shtuar fjalë në shkronjën “a” dhe shtuar shkronja “a/1” të pikes 1 me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

1. Huadhënësi do të japë Hua të garantuar sipas kësaj Marrëveshje, vetëm Huamarrësve, të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) Huamarrësi duhet të bëjë pjesë në kategorinë e subjekteve të prekura nga vendimet e qeverisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, në përputhje me listën e kategorive të subjekteve bashkëlidhur kësaj Marrëveshje në Aneksin 2, sipas tekstit bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje.

a/1. Huamarrësi nuk duhet të ketë kredi me probleme (këto sipas definicionit të rregullores së Bankës së Shqipërisë nr.62, datë 14.9.2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, të ndryshuar), në muajin shkurt 2020.

b) Huamarrësi duhet të ketë aftësi ripaguese për të marrë hua në linjë me kriteret që operon sektori bankar në Republikën e Shqipërisë, e vlerësuar kjo në përputhje me kushtet e aplikuara nga Huadhënësi përpara shpalljes së fatkeqësisë natyrore dhe në diskrecionin e plotë të Huadhënësit.

c) Qëllimi i përdorimit të fondeve të Huasë do të jetë vetëm për të paguar pagat e punonjësve të Huamarrësit, bazuar në listëpagesat e procesuara pranë Huadhënësit në muajin shkurt.

d) Huamarrësi duhet të nënshkruaj Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas formës dhe përmbajtjes të paracaktuar në Aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje.

e) Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

2. MFE gëzon të drejtën që në cdo moment të rishikojë, shtojë ose heq cdo njërin prej kriterëve të cituara në pikën 1 të këtij neni, duke dakordësuar paraprakisht me Huadhënësin. Ky ndryshim do të bëhet efektiv menjëherë pas negocimit dhe marrjes së njoftimit me shkrim të MFE nga Huadhënësi. Asnjë ndryshim i bërë në përputhje me këtë pikë nuk do të ndikojë mbi Huamarrësit, Huaja e të cilëve është aprovuar përpara datës së bërjes efektive të këtij ndryshimi.

3. Me përjashtim të rasteve të vecanta, ashtu si përcaktohet në pikën 2 të nenit 3, Huadhënësi në asnjë rast nuk do të aprovojë kërkesat për Hua të Huamarrësve të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Huadhënësi do të shqyrtojë kërkesat për Hua e Huamarrësve mbi bazën e “i pari në kohë, i pari në të drejtë”, duke mos diskriminuar asnjë prej Huamarrësve.

Neni 4

(Detyrimet e Huadhënësit)

1. Huadhënësi merr përsipër të përdorë format e aplikimit, të cilat garantojnë sigurimin e të gjithë informacionit të cituar nenin 3 të kësaj marrëveshjeje, sipas praktikave të tij bankare për këto produkte.

2. Huadhënësi mban përgjegjësi për plotësimin e dokumenteve të aplikimit për Hua dhe mban kopje të këtyre dokumenteve në arkivat e veta.

3. Huadhënësi merr masat që stafi i burimeve njerëzore, i cili do të angazhohet me kredidhënien të ketë ekspertizën e duhur dhe të jetë familjar me politikat dhe procedurat e kësaj skeme garancie.

4. Huadhënësi do t'i trajtojë Huatë që do të jenë pjesë e kësaj skeme garancie në përputhje me kriteret dhe procedurat e brendshme që ai aplikon gjatë aktivitetit të tij të zakonshëm të kredidhënies, duke i'u referuar gjëndjes së Huamarrësit në muajin shkurt 2020. Gjithashtu, Huadhënësi zotohet t'i trajtojë këto Hua me të njëjtin kujdes dhe profesionalizëm, sikundër vepron me huatë e tjera tregtare që ai ofron.

5. Huadhënësi duhet të regjistrojë huanë menjëherë pas lëvrimit në regjistrin e kredive me një emërtim të vecantë "Kredi për pagat brenda programit të Garancisë Sovrane për situatën e COVID-19".

6. Huadhënësi ka detyrimin të verifikojë nëpërmjet regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë nëse Huamarrësi është përfitues i ndonjë Huaje brenda të njëjtut program nga Huadhënësi të tjerë.

7. Në rast se Huamarrësi ka marrë një hua për këtë program nga banka të tjera çdo hua tjetër për paga nuk do të jetë subjekt i kësaj marrëveshjeje.

8. Huadhënësi nuk do të favorizojë ndonjë prej Huamarrësve, mbi bazën e kriterëve të tij preferencialë.

9. Huadhënësi do të vendos në dispozicion të MFE, me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, të ekstrakteve, të dokumenteve, të rekordeve dhe të shkresave të të gjitha Huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshje Garancie.

10. Huadhënësi, shqyrton dokumentacionin e nevojshëm dhe aprovon Huanë brenda një afati 10 ditor nga momenti i aplikimit si dhe garanton kalimin e fondeve në llogarinë e pagamarrësve, sipas pikës 1 të nenit 5.

Neni 5

(Kriteret e Huasë)

(ndryshuar pika 5 dhe 6 me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

1. Vlera e Huasë e vendosur në dispozicion nga Huadhënësi për Huamarrësin mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Huamarrësi, por duke mos tejkaluar në asnjë rast vlerën e 3 pagave mujore bruto të punonjësve të deklaruar. Në asnjë rast vlera mujore bruto e pagës për punonjës nuk do të jetë më e lartë se 150 000 lekë.

Huamarrësi është i detyruar t'i paraqesë Huadhënësit detajimin e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përkatësisht për secilën pagë që do të procesohet.

2. Jetëgjatësia e Huasë do të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por duke mos tejkaluar në asnjë rast jetëgjatësinë prej 2 vitesh.

3. Huaja do të ketë një periudhë Grace (periudhë pa pagesë principali) prej 3 muaj.

4. Monedha e Huasë do të jetë në monedhën vendase (lekë).

5. Huadhënësi do të ofrojë Huanë me një normë interesi preferencialë, të barabartë me normën mesatare të interesit të tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit 12 mujore plus një marzh prej 0.5%, por në asnjë rast norma e interesit nuk do të jetë më e lartë se 2.85%.

Kjo normë interesi do të fiksohet në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit dhe do të qëndrojë e pandryshuar deri në përfundimin e afatit të Huasë.

6. Huadhënësi nuk do të aplikojë tarifa, komisione, penaltete, kamatëvonesa apo çfarëdolloj mase tjetër që mund të krijojë kosto për Huamarrësin dhe MFE, përpos atyre të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

7. Termat dhe kushtet e Huasë do të përcaktohen në Marrëveshjen e Huasë, e cila do të nënshkruhet ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit, në përputhje me përmbajtjen e këtij neni.

8. Asnjë transferim i të drejtave apo detyrimeve të Huadhënësit që burojnë nga kjo Marrëveshje ose nga Marrëveshja e Huasë nuk mund t'i transferohet palëve të treta pa marrë paraprakisht aprovimin me shkrim të MFE-së.

9. Per çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huasë, që mund të bëhet në marrëveshje ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, nuk është i nevojshëm miratimi i MFE. Këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e Huadhënësit kundrejt MFE-së, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Huadhënësi do të njoftojë me shkrim MFE-në për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huasë.

10. Huadhënësi është përgjegjës që shuma totale e Huave të lëvruara në favor të Huamarrësve, të mos tejkalojë masën e garancisë së lëshuar nga MFE në favor të tij sipas nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje. Në asnjë rast, tejkalimi i masës së garancisë nuk do të përbëjë detyrim për MFE-në.

Neni 6

(Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë)

1. Kur Huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë dhe kur Huadhënësi brenda një periudhë jo më pak se 120 ditë (nga dita e parë e mos pagesë së detyrimit nga Huamarrësi) ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e detyrimeve në përputhje me procedurat dhe praktikën e sektorit bankar, atëherë Huadhënësi rezervon të drejtën për t'i dërguar MFE-së kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve ("Kërkesa për Pagesë") të Huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për Pagesë që Huadhënësi do t'i drejtojë MFE-së duhet të përmbajë:

a) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe çdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të Marrëveshjes së Huasë dhe që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm detyrimin e principalit të Huasë.

b) Një përshkrim të gjithë procedurave të ndjekura nga Huadhënësi përgjatë periudhës 120 ditore për të recuperuar detyrimet nga Huamarrësi nga momenti i gjenerimit të detyrimit deri në momentin e dërgimit të Kërkesës për Pagesë.

c) Numrin e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga MFE.

3. MFE, pasi vëren se Kërkesa për Pagesë është në përputhje me Pikën 2 të këtij Neni dhe kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësin brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për pagesë.

4. Nëse MFE e vlerëson të arsyeshme, përpara autorizimit për kryerjen e pagesës dhe brenda afateve të përcaktuara në Pikën 3 të këtij Neni, mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga Huadhënësi.

5. MFE nuk ka asnjë detyrim ndaj Kërkesave për Pagesë, të cilat mund të burojnë nga vjedhja, materializimi i risqeve operationale të Huadhënësit, ose për çdo arsye tjetër që nuk është konsistente me këtë Marrëveshje.

Neni 7

(Rikuperimi post-pagesës së garancisë)

1. Pas pagesës së garancisë për ndonjë prej Huave, MFE në mirëkuptim me Huadhënësin mund të nënshkruajë një marrëveshje të vecantë, nëpërmjet së cilës MFE mund të autorizojë Huadhënësin që të vazhdojë të bëjë përpjekje për të rikuperuar detyrimin në përputhje me procedurat ligjore dhe praktikën e sektorit bankar.

2. Nëse pas pagesës së garancisë nga MFE për ndonjë prej Huave, Huadhënësi me vullnetin e tij të lirë, ose për çfarëdo lloj arsye tjetër ndodh që të rikuperoj një pjesë ose të gjithë detyrimin e Huasë që paraprakisht është paguar nga garancia, Huadhënësi brenda një afati prej 15 ditë pune duhet të njoftoj me shkrim MFE-në, e cila do të instruktojë Huadhënësin në lidhje me detajet e pagesës. Pagesa nga Huadhënësi do të kryhet jo më vonë se 15 ditë pune nga data e marrjes së instruksioneve me detajet e pagesës nga MFE. Shuma që Huadhënësi do të paguaj në favor të MFE-së, do të jetë e barabartë me shumën e rikuperuar të Huasë, pasi t'i jenë zbritur, interesat, penalitetet dhe shpenzimet që Huadhënësi mund të ketë kryer për të mundësuar rikuperimin e fondeve të Huasë. Në asnjë rast, pagesa e kryer nga Huadhënësi për fondet e rikuperuara në favor të MFE-së nuk do të jetë më e lartë se pagesa e garancisë që MFE ka kryer për të njëjtën Hua në favor të Huadhënësit.

3. Nëse ndodh që pas përfundimit të kësaj Marrëveshje, të ketë ndonjë rast analog, si në pikën 2 të këtij neni, Huadhënësi ka detyrimin të vijojë me pagesën në favor të MFE-së deri në 3 vite pas përfundimit të Marrëveshjes.

Neni 7/1

(Rimbursimi i interesave)

(shtuar me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

1. MFE do t'i rimbursojë Huadhënësit interesat që burojnë nga Huatë e garantuara nga kjo Marrëveshje Garancie një herë në tre muaj, ku tremujori i parë do të fillojë të përllogaritet nga data e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nuk do të gjenerohen dhe nuk do të rimbursohen interesa për më shumë se 30 ditë pa pagesë principali nga data që i ka lindur detyrimi Huamarrësit për të paguar principalin sipas Marrëveshjes së Huasë.

3. Huadhënësi çdo 90 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të dërgojë pranë MFE kërkesën për rimbursimin e interesave ("Kërkesa për rimbursim") në formë elektronike dhe të shkruar. Kërkesa për rimbursim duhet të përmbajë informacion të detajuar në lidhje me interesat e gjeneruara dhe mënyrën e përllogaritjes së tyre, për secilën Hua që Huadhënësi ka lëvruar në përputhje me këtë Marrëveshje.

4. MFE, pasi shqyrton informacionin dhe verifikon përllogaritjet e kërkesës për rimbursim, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësin brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për rimbursim.

5. Nëse MFE e vlerëson të arsyeshme, përpara autorizimit për kryerjen e pagesës dhe brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga Huadhënësi.

Neni 8

(Raportimi dhe monitorimi)

1. Huadhënësi çdo të hënë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE-së (ose strukturës që do të autorizoj MFE-në për këtë qëllim) për Huatë e aprovuara prej tij në javën paraardhëse, duke përcjellë shumën e disbursuar dhe skedulën e amortizimit të Huave, si edhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë Kriteret e Kualifikimit të Huamarrësve.

2. Huadhënësi gjithashtu do të raportojë në formë elektronike dhe shkresore në bazë mujore pranë MFsë (ose strukturës që do të autorizoj MFE-në për këtë qëllim), jo më vonë se 15 ditë nga mbyllja e secilit muaj, ecurinë e shlyerjes së Huasë, duke përfshirë në raportim informacion në lidhje me pagesat e kryera të Huasë nga Huamarrësi dhe vlerën e mbetur të Huasë.

3. Raportimet në lidhje me këtë nen duhet të bëhen me shkrim ose në formë elektronike sipas rasteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Ato duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

[Adresa e MFE]

Në vëmendje të:

E-mail:

Faks:

Për Bankën XYZ:

[Adresa e Bankës XYZ]

Në vëmendje të:

E-mail:

Faks:

Neni 9

(Zgjidhja e mosmarrëveshjeve)

Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë marrëveshje, apo shkelja, zgjidhja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët. Nëse palët nuk arrijnë t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, ato do të zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 10

(Hyrja në fuqi dhe efektiviteti)

(shtuar me VKM nr. 370, datë 6.5.2020)

Kjo Marrëveshje Garancie do të hyjë në fuqi, pas nënshkrimit nga palët dhe do të bëhet efektive pas disbursimit të Huasë ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit.

Neni 10/1

(Vlefshmëria e dispozitave)

Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

(Nënshkrimi)

Palët kontraktuese nënshkruajnë këtë marrëveshje në 2 kopje në gjuhën shqipe (një kopje për MFE-në dhe një kopje për Huadhënësin), në Tiranë, Shqipëri, në datat e përcaktuara në krye të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

(Përfundimi dhe pezullimi marrëveshjes)

1. Kjo Marrëveshje Garancie do të quhet e përfunduar kur të gjitha detyrimet ndërmjet palëve, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Huasë dhe kjo marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht, në rast se nuk do të kërkohej përfundimi përpara kohe i saj nga ana MFE-së ose Huadhënësi. Në rast se do të kërkohej përfundimi i kësaj marrëveshjeje përpara kohe, ky proces nuk do të ndikojë në detyrimet e lindura deri në atë moment.

2. MFE mund të pezullojë Marrëveshjen e Garancisë në çdo kohë, duke i dërguar një njoftim zyrtar Huadhënësit, në rast të ndodhjes së ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) Në rast se MFE vërteton se Huadhënësi ka kryer një shkelje të kësaj Marrëveshje ose është përfshirë në një mashtrim i cili ka ndikim të drejtëpërdrejtë tek MFE;

b) Në rast se Huadhënësi nuk ka bërë asnjë disbursim huaje 60 ditë nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Garancisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE

PËRFAQËSUAR NGA

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

MINISTËR

[EMËR MBIEMËR]

PËR BANKËN XYZ

ADMINISTRATOR

[EMËR MBIEMËR]

Aneksi 1

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Bazuar në nenin 38 të ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

[*Emërtimi i Huamarrësit*] bie dakord të nënshkruaj këtë Memorandum Mirëkuptimi në datën ____/____/2020 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi Garancisë Shtetërore të Huasë, sipas Marrëveshjes së Garancisë nr._____, datë____/____/2020.

Në rast kompensimi të humbjeve nga MFE për pagesa që burojnë nga Marrëveshja e Huasë sipas Marrëveshjes së Garancisë cituar në pragrafin e mësipërm, [*Emërtimi i Huamarrësit*] bie dakord që të bëjë përpjekje të arsyeshme për t’i kthyer MFE-së shumën/shumat që kjo e fundit i ka paguar Huadhënësit, përfshirë edhe të gjitha kostot që mund të lidhen me to.

Në rast të kundërt, [*Emërtimi i Huamarrësit*] është në dijeni se MFE rezervon të drejtën për të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe në ligje të tjera në fuqi për të përfituar kthimin e çdo kompensimi të kryer sipas Marrëveshjes së Garancisë.

Nëse në fund të periudhës së huasë sipas marrëveshjes së garancisë, Huamarrësi nuk kthen detyrimin ndaj Huadhënësit, ai humbet të drejtën e aksioneve të cilat do të shiten nga struktura përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

[*Emërtimi i Huamarrësit*]

Nënshkrimi

Aneksi 2

LISTA E BIZNESEVE TË PREKURA NGA VENDIMET E QEVERISË NË KUADËR TË MENAXHIMIT TË SITUATËS NGA COVID-19